

**SKEMA E VLERËSIMIT TË TESTIT TË PROVIMIT TË MATURËS DHE PROVIMIT PROFESIONAL
NGA GJUHA SHQIPE DHE LETËRSIA, QERSHOR 2023**

1. Nxënësi/nxënësj* merr **1 pikë** nëse ka shkruar: Rreth 15 për qind
2. Është rrethuar numri 2: *objektet me vrima – 1 pikë*
3. Nxënësi merr **1 pikë** nëse ka shkruar: Të qëndrojnë në shtëpi. *(dhe përgjigje të tjera të sakta)*
4. Nxënësi merr **1 pikë** nëse ka shkruar: Frika nga ata që janë ndryshe nga vetvetja. *(dhe përgjigje të tjera të sakta)*
5. Gjithsej **2 pikë** për përgjigje plotësisht të saktë: Araknofobët kanë frikë nga merimangat dhe ajo frikë shfaqet nga neveria deri te paniku.

Nxënësi merr **1 pikë** nëse jep përgjigjen e pjesshme vetëm nëse shkruan se nga çka kanë frikë araknofobët ose vetëm si manifestohet ajo.
6. Nxënësi merr **1 pikë** nëse ka shkruar: Frika nga të vjellët
7. Është rrethuar numri 3: *përshkrim – 1 pikë*
8. Nxënësi merr **1 pikë** nëse ka shkruar: Varrimi i Xha Gorios *(dhe përgjigje të tjera të sakta)*
9. Është rrethuar numri 4: *pikëllimi – 1 pikë*
10. Nxënësi merr **1 pikë** nëse ka shkruar: Realizëm
11. Nxënësi merr **1 pikë** nëse ka shkruar përgjigje plotësisht të saktë: *Hamleti, Eugjen Onjegjin, Këngët e Milosaos, Andrra e jetës dhe Duke pritur Godonë*
12. Nxënësi merr **1 pikë** nëse ka shkruar: Bujku, bariu, baresha, vasha

*Në tekstin e mëtejshëm nxënësi

13. Gjithsej 2 pikë

Në vargun e parë autori përdor figurën e apostrofës *1 pikë*, kurse në vargun e tetë dhe të nëntë krahasimin e zhvilluar apo përngjasimin *1 pikë*.

14. Gjithsej 3 pikë:

A) Nxënësi ka rrethuar përgjigjen 2: *vetërrëfimin* - *1 pikë*

B) Nëse e argumenton përgjigjen në A duke treguar frymën romantike që e përshkon fragmentin *1 pikë* dhe rishkruar vargjet ku poeti përdor trajtën e vetërrëfimit: *Ti Shqipëri, më ep nderë, më ep emërin Shqipëtar*

Zemërën ti ma gatove plot me dëshirë dhe me zjarr.

Shqipëri! O mëma ime! Ndonëse jam i mërguar,

Dashurinë tënde kurrë, zemëra s'e ka harruar. - 1 pikë

15. Nxënësi merr 2 pikë nëse ka zgjedhur: *është makinë e krimi* dhe zgjedhjen e vet e argumenton me pohimin se pasioni për pushtet e verbon Hamletin dhe e kthen në makinë të krimi (Krimi ndaj mbretit, krimi në familje...). (*dhe përgjigje të tjera të sakta*)

Nxënësi merr *1 pikë* për përgjigje të pjesshme, vetëm veçimin e saktë të karakterit të Hamletit ose vetëm për argumentimin e saktë të zgjedhjes së vet.

16. Gjithsej 2 pikë

A) Nxënësi merr *1 pikë* nëse shkruan ndonjë nga detajet: Mbajti një gjakftohtësi shembullore; Fshehu fatkeqësinë e vet etj.

B) Nxënësi merr *1 pikë* nëse e argumenton përgjigjen: Tashmë ajo mund të fshihte fatkeqësinë e vet, pa e kuptuar njeri.; Ajo e zotëronte veten plotësisht. (*dhe përgjigje të tjera të sakta*)

17. Është rrethuar numri 2: përfshirja e qenieve përralore - 1 pikë

18. Gjithsej 2 pikë

A) Nxënësi merr *1 pikë* nëse ka shkruar: Kritikës letrare

B) Nxënësi merr *1 pikë* nëse ka shkruar: Ligjërimit profesional (Ligjërimit libror)

19. Nxënësi merr 1 pikë nëse shkruan: pleqëri

20. Nxënësi merr 1 pikë nëse shkruan: Këmbët e tij të shumta, fije të holla mjerane në krahasim me pjesën tjetër masive të trupit, valëvisnin pa kuptim para syve të tij. Ose valëviteshin/valëvisnin

- 21. Nxënësi merr 1 pikë** nëse shkruan: 1. Toleroj – jam i durueshëm/kam durim;
2. Inkurajoj – jap zemër/jap mbështetje
3. Inskenoj – vë në skenë
(dhe përgjigje të tjera të sakta)

22. Gjithsej 2 pikë:

- A) Nxënësi merr 1 pikë nëse ka rrethuar numri 1: çkatërroj
- B) Nxënësi merr 1 pikë nëse argumenton përgjigjen nën A: shkruhet me *sh* (shkatërroj) fjala kur *sh* ndiqet nga një bashkëtingëllore e shurdhët në këtë rast *k*.

23. Gjithsej 2 pikë:

Nxënësi merr 1 pikë për zgjerimin e fjalisë me një pjesë të nënrenditur rrethimore kohore: *Sapo ktheu vështrimin andej, buzëqeshi e mrekulluar.* (dhe përgjigje të tjera të sakta)

Nxënësi merr 1 pikë për zgjerimin e fjalisë me një pjesë të nënrenditur rrethimore mënyrore: *Buzëqeshi e mrekulluar, si të ishte vërtetë e lumtur.*

24. Skema e vlerësimit të tekstit funksional

FORMA DHE PËRMBAJTJA E TEKSTIT 3 pikë	GJUHA 3 pikë	STILI 2 pikë
Të gjitha të dhënat e shkruara në udhëzim janë renditur sipas parimeve të hartimit të tekstit. 3 pikë	Në tekst nuk ka gabime gramatikore dhe drejtshkrimore. 3 pikë	Fjalitë janë ndërtuar qartë dhe janë në përputhje me përmbajtjen dhe formën e tekstit. 2 pikë
Të gjitha të dhënat janë renditur mirë, por mungon ndonjë e dhënë që e vështirëson kuptimin e tekstit, përkatësisht elementi kryesor që nuk e përmbys formën e tekstit. 2 pikë	Norma drejtshkrimore dhe gramatikore pjesërisht është respektuar, por ka lëshime si: - përdorimi i shenjave të pikësimit - përdorimi i drejtë i pjesëve gramatikore 2 pikë	Në tekst ka gabime stilistike (p.sh. përsëritja e fjalëve të njëjta në një fjali ose në fjalitë që pasojnë/ drejtohet në mënyrë të gabuar/ përdorimi i pleonazmës/ mungesë e të shprehurit/
	Normat gramatikore dhe drejtshkrimore janë respektuar pjesërisht:	

<p>Mungojnë shumë të dhëna, por teksti kuptohet. <i>1 pikë</i></p> <p>Nuk është respektuar forma e dhënë ose përmbajtja e tekstit është e pakuptueshme. <i>0 pikë</i></p>	<p>- nuk përdoret si duhet gjuha letrare, por e folura dialektore</p> <p>- gabon në përdorimin e shenjave të pikësimit (p.sh. nuk përdor presjen gjatë numërimit, gjatë ndërtimit të fjalive të nënrenditura</p> <p>dhe/apo</p> <p>- gabon në përdorimin e parafjalëve... <i>1 pikë</i></p> <p>Në tekst ekzistojnë tri apo më shumë gabime thelbësore të gjuhës standarde (përdorimi i gabuar i rasave, gabime në përdorimin e shkronjës së madhe, nuk respekton rregullat e shkrimit të fjalëve bashkë dhe ndaras, zbatimi i njohurive për alternimin e zanoreve, gabon në përdorimin e zanores ë, nuk zbaton rregullat sipas të cilave nuk shkruhet bashkëtingëllorja <i>j</i>, gabon në përdorimin e trajtës mohuese. <i>0 pikë</i></p>	<p>theksimi i tepruar i të dhënave. <i>1 pikë</i></p> <p>Fjalitë nuk janë ndërtuar mirë, janë të paqarta, të papërfunduara... <i>0 pikë</i></p>
---	---	---

25. Skema e vlerësimit të esesë:

Çajl Haroldi – XH.G.Bajron

Përmbajtja 7 pikë

<p>Respektimi i kërkesave të dhëna</p>	<p>Hartimi i një teksti që i përshtatet kërkesave të dhëna: - shkruan për përmbajtjen e veprës Çajl Haroldi (<i>1 pikë</i>) - tregon për pikëpamjet estetike të veprës, motivet e konfliktit. Në çfarë dallohen ato? (<i>1 pikë</i>)</p>
--	--

	- shkruan për veçoritë e Çajld Haroldit (1 pikë) Gjithsej 3 pikë
Mendimi kritik, përdorimi i të dhënave, argumentimi dhe dhënia e qëndrimit personal, mendimit idesë...	Krijimi i tekstit: - qasja origjinale/ kreative ndaj temës (1 pikë) - përdorimi dhe lidhja e shembujve relevant gjatë hartimit të temës/ të dhënave në zhvillimin e temës (1 pikë) - argumentimi i hollësishëm dhe lidhja e shembujve/ të dhënave në zhvillimin e temës (1 pikë) - argumentimi me fakte dhe qëndrime personale (1 pikë) Gjithsej 4 pikë

Gjuha dhe struktura e tekstit – 6 pikë

GJUHA 3 pikë	STILI 2 pikë	FORMA GRAFIKE E TEKSTIT 1 pikë
Në tekst nuk ka gabime gramatikore dhe drejtshkrimore. 3 pikë	Fjalitë janë ndërtuar qartë dhe janë në përputhje me përmbajtjen dhe formën e tekstit. 2 pikë	Përshtatja e organizimit të tekstit duke përshtatur formën e shkrimit me anën logjike (ndahen qartë hyrja, zhvillimi dhe përfundimi) 2 pikë
Norma drejtshkrimore dhe gramatikore përgjithësisht respektohet dhe është përdorur si e tillë: - përdorimi i shenjave të pikësimit dhe i formulimeve gjuhësore 2 pikë	Në tekst ka gabime stilistike (p.sh. përsëritja e fjalëve të njëjta në një fjali ose në fjalitë që pasojnë/ drejtohet në mënyrë të gabuar/ përdorimi i pleonazmës/ mungesë e të shprehurit/ theksimi i tepruar i të dhënave. 1 pikë	Mospërshtatja e formës së tekstit strukturës së tij logjike (nuk ndahen hyrja, zhvillimi dhe përfundimi). 0 pikë
Normat gramatikore dhe drejtshkrimore janë respektuar pjesërisht: - nuk përdoret si duhet gjuha letrare, por e folura dialektore - gabon në përdorimin e shenjave të pikësimit (p.sh. nuk përdor presjen gjatë numërimit, gjatë ndërtimit të fjalive të nënrenditura	Fjalitë nuk janë ndërtuar mirë, janë	

<p>dhe/apo - gabon në përdorimin e parafjalëve... <i>1 pikë</i></p> <p>Në tekst ekzistojnë tri apo më shumë gabime thelbësore të gjuhës standarde (përdorimi i gabuar i rasave, gabime në përdorimin e shkronjës së madhe, nuk respekton rregullat e shkrimit të fjalëve bashkë dhe ndaras, zbatimi i njohurive për alternimin e zanoreve, gabon në përdorimin e zanores ë, nuk zbaton rregullat sipas të cilave nuk shkruhet bashkëtingëllorja j, gabon në përdorimin e trajtës mohuese. <i>0 pikë</i></p>	<p>të paqarta, të papërfunduara... <i>0 pikë</i></p>	
--	--	--

Skema e vlerësimit të esesë:

Mos i ndërprit të tjerët kur flasin dhe mos i përfundo ti fjalitë e tyre

Përmbajtja 7 pikë

<p>Respektimi i kërkesave të dhëna</p>	<p>Hartimi i një teksti që i përshtatet kërkesave të dhëna:</p> <ul style="list-style-type: none"> - tregon për sjelljen që ka në raport me ndërprerjen e të tjerëve kur flasin ata dhe përfundimin e fjalëve të tyre <i>(1 pikë)</i> - shkruan për dëmet, pasojat e këtij vesi ndaj respektit dhe dashurisë që merr nga të tjerët dhe energjinë që harxhohet duke u përpjekur të jetë brenda mendjes së dy personave. Për reagimin e të tjerëve ndaj një sjellje të tillë <i>(1 pikë)</i> - shkruan për dëshirën që ka të ndryshojë veten apo të tjerët, nëse e kanë një prirje të tillë që është që është një zakon i bezdisshëm e që mund të bëhet edhe refleks i keq. Shkruan për ndjenjat e veta dhe të tjerëve nëse e ka bërë apo e kanë bërë këtë <i>(1 pikë)</i> <p><i>Gjithsej 3 pikë</i></p>
--	---

<p>Mendimi kritik, përdorimi i të dhënave, argumentimi dhe dhënia e qëndrimit personal, mendimit idesë...</p>	<p>Krijimi i tekstit:</p> <ul style="list-style-type: none"> - qasja origjinale/ kreative ndaj temës (1 pikë) - përdorimi dhe lidhja e shembujve relevant gjatë hartimit të temës/ të dhënave në zhvillimin e temës (1 pikë) - argumentimi i hollësishëm dhe lidhja e shembujve/ të dhënave në zhvillimin e temës (1 pikë) - argumentimi me fakte dhe qëndrime personale (1 pikë) <p>Gjithsej 4 pikë</p>
---	--

Gjuha dhe struktura e tekstit – 6 pikë

<p>GJUHA 3 pikë</p>	<p>STILI 2 pikë</p>	<p>FORMA GRAFIKE E TEKSTIT 1 pikë</p>
<p>Në tekst nuk ka gabime gramatikore dhe drejtshkrimore. <i>3 pikë</i></p> <p>Norma drejtshkrimore dhe gramatikore përgjithësisht respektohet dhe është përdorur si e tillë:</p> <ul style="list-style-type: none"> - përdorimi i shenjave të pikësimit dhe i formulimeve gjuhësore <i>2 pikë</i> <p>Normat gramatikore dhe drejtshkrimore janë respektuar pjesërisht:</p> <ul style="list-style-type: none"> - nuk përdoret si duhet gjuha letrare, por e folura dialektore - gabon në përdorimin e shenjave të pikësimit (p.sh. nuk përdor presjen gjatë numërimit, gjatë ndërtimit të fjalive të nënrenditura <p>dhe/apo</p> <ul style="list-style-type: none"> - gabon në përdorimin e 	<p>Fjalitë janë ndërtuar qartë dhe janë në përputhje me përmbajtjen dhe formën e tekstit. <i>2 pikë</i></p> <p>Në tekst ka gabime stilistike (p.sh. përsëritja e fjalëve të njëjta në një fjali ose në fjalitë që pasojnë/ drejtohet në mënyrë të gabuar/ përdorimi i pleonazmës/ mungesë e të shprehurit/ theksimi i tepruar i të dhënave. <i>1 pikë</i></p> <p>Fjalitë nuk janë ndërtuar mirë, janë të paqarta, të papërfunduara... <i>0 pikë</i></p>	<p>Përshtatja e organizimit të tekstit duke përshtatur formën e shkrimit me anën logjike (ndahen qartë hyrja, zhvillimi dhe përfundimi) <i>2 pikë</i></p> <p>Mospërshtatja e formës së tekstit strukturës së tij logjike (nuk ndahen hyrja, zhvillimi dhe përfundimi). <i>0 pikë</i></p>

<p>parafjalëve...</p> <p><i>1 pikë</i></p> <p>Në tekst ekzistojnë tri apo më shumë gabime thelbësore të gjuhës standarde (përdorimi i gabuar i rasave, gabime në përdorimin e shkronjës së madhe, nuk respekton rregullat e shkrimit të fjalëve bashkë dhe ndaras, zbatimi i njohurive për alternimin e zanoreve, gabon në përdorimin e zanores ë, nuk zbaton rregullat sipas të cilave nuk shkruhet bashkëtingëllorja <i>j</i>, gabon në përdorimin e trajtës mohuese.</p> <p><i>0 pikë</i></p>		
--	--	--